



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**15 VJET**

**INFORMIM DHE PRIVATËSI**

**Nr. 15**

# Përmbajtja

	faqja
28 Janar – Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale	3
Epoka digjitale dhe mbrojtja e të dhënave personale në sektorin bankar	4
Njohje, ndërgjegjësim dhe edukim për mbrojtjen e të dhënave personale	5
Partneritet për rritjen e transparencës në funksion të interesit publik	5
Garantimi i të drejtave të qytetarëve, standarde bashkëkohore në zbatimin e kuadrit rregullator	6
Udhëzuesi “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”	7
Konsultimi publik i ndryshimeve në ligjin “Për të drejtën e informimit”	8-9
Komisioneri, z. Besnik Dervishi, i ftuar në intervistë në Zërin e Amerikës	9
15 vjet Zyra e Komisionerit, Konferenca V Kombëtare “E Drejta për Informim – Hapje, Transparencë, Digjitalizim”	10-11
Samiti Vjetor i IAPP, takime të Komisionerit Dervishi me zyrtarë të lartë amerikanë	12
Ambasadori i Prezencës së OSBE në Shqipëri viziton Zyrën e Komisionerit	13
Procesi i integritimit evropian, përmirësimi i kapaciteteve profesionale	13
Roli global i të drejtës për informim për konsolidimin e demokracisë - Konferenca e 14-të e ICIC	14
Forum për rolin e Zyrës së Komisionerit në promovimin e të drejtës për informim	15
Kuvendi miraton Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2022	15
Zbatimi i legjislacionit për fushat e përgjegjësisë, takime në Gjirokastrë	16
Procesi i integritimit evropian, kontributi i Zyrës së Komisionerit	16
Legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale, forumi i biznesit nga Dhoma Amerikane e Tregtisë	17
Shkëmbimi i praktikave të mira në funksion të transparencës së Autoriteteve Publike	17
Projekti “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave”	18
Konsultimi i “Udhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”	19
Komisioneri në media	19

Revista **“Informim Dhe Privatësi”**

Redaksia: Redi Skënderaj, Alketa Koja, Segi Berberi, Denada Hysi, Brikena Tepelena.


**Nr. 15 , Qershor 2023**

Print: Quantic

## 28 Janar – Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

28 Janari është Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe në botë njihet ndryshe edhe si Dita e Privatësisë - Privacy Day.

Njohja, ndërgjegjësimi dhe promovimi në tërësi i të drejtave dhe lirive themelore të individit është një nga detyrat kryesore të autoriteteve publike për forcimin e vetëdijes qytetare. Një shoqëri demokratike e shëndetshme nuk mund të kuptohet pa një proces të vazhdueshëm edukativ për kultivimin e kulturës në ushtrimin praktik të këtyre të drejtave. Në këtë kontekst, e sidomos duke marrë në konsideratë



varësisë, të pavarura apo të vetëqeverisjes vendore, për t'u publikuar në faqet zyrtare të internetit, si edhe subjekteve mediatike publike e private për t'u transmetuar në kanalet audiovizuale, të cilat iu përgjigjën pozitivisht kësaj nisme.

Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit përgatiti dhe shpërndau në platformat/rrjetet sociale një poster me fokus të rinjtë për ndërgjegjësimin e tyre në përdorimin e sigurt të internetit, si një tjetër iniciativë shumë e



përparimin teknologjik dhe digjitalizimin, mbrojtja e të dhënave personale është shumë e rëndësishme dhe në themel të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë. Kjo qasje ka për qëllim të rrisë përgjegjshmërinë si në sferën publike, ashtu edhe në atë private, për ofrimin e shërbimeve me cilësi, të sigurta dhe transparente.

Zyra e Komisionerit në kuadër të aktiviteteve për Javën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale 2023 përgatiti posterin elektronik dhe një video. Këto materiale ndërgjegjësuese iu shpërndanë autoriteteve (kontrolluesve) publike qendrore e të



rëndësishme në funksion të promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Më 28 janar 1981 u miratua nga Këshilli i Evropës Konventa 108 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale". Vendi ynë e ka përfshirë në legjislacionin kombëtar këtë dokument, me miratimin e ligjit nr. 9288/2004. Konventa është modernizuar në maj të vitit 2018 (Konventa 108+) me miratimin e Protokollit CETS No. 223, i cili u nënshkrua në 28 janar 2022 edhe nga Shqipëria dhe është bërë pjesë e legjislacionit kombëtar nëpërmjet ligjit nr. 49/2022.

## Epoka digjitale dhe mbrojtja e të dhënave personale në sektorin bankar

Teknologjia dhe digjitalizimi mundëson që shumë procese dhe shërbime të kryhen në mënyrë të automatizuar, por nga ana tjetër, shtohet rreziku për keqpërdorimin e të dhënave personale nëse nuk përmbushen detyrimet e përcaktuara rregullatore.



Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm, me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Tiranë, organizuan tryezën e rumbullakët me tematikë “Epoka digjitale dhe mbrojtja e të dhënave personale brenda sektorit bankar.” Takimi u mbajt në kuadër të aktiviteteve të Javës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ku të pranishëm ishin ambasadorja

e Zvicrës, znj. Ruth Huber, si dhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave.

Në përshëndetjen e tij, Komisioneri Dervishi theksoi se në epokën digjitale, monedha e shkëmbimit janë të dhënat personale, çka nga ana tjetër janë dhe një ndër pasuritë më të çmuara të njeriut. *“Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në trekëndëshin qytetar-autoritet mbikëqyrës-kontrollues, nënkupton balancë për respektimin e kësaj të drejte në një ekonomi të zhvilluar. Përputhshmëria me këto standarde bashkëkohore kërkon investime afatgjata: në drejtim të burimeve njerëzore; masave tekniko-organizative dhe mekanizmave vetërregullues, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave.”* Nga ana e saj ambasadorja Huber vlerësoi se *“mbi gjithçka, duhet ta trajtojmë mbrojtjen e të dhënave si një çështje të legjislacionit, politikave, rregulloreve dhe kapaciteteve. Po kështu, ne duhet të investojmë në ndërgjegjësimin dhe sjelljen e përgjegjshme të qytetarëve.”*



Ky aktivitet ishte i pari në kuadër të projektit “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave”, ku për të pranishmit referoi eksperti i kësaj fushe, z. Emirjon Marku. Në të u diskutua mbi rolin që sektori bankar ka për ekonominë e vendit, në funksion të përmbushjes së detyrimeve rregullatore të mbrojtjes së të dhënave personale, në harmoni me ato të fushave të tjera. Në këtë tryezë u diskutua mbi informimin dhe dhënien e pëlqimit nga qytetarët; konceptin e mjaftueshmërisë së të dhënave apo saktësinë e tyre; kohëzgjatjen e përpunimit; ruajtja, etj. Njëkohësisht, u trajtuan edhe risitë në kontekstin e modernizimit të legjislacionit sipas standardeve të GDPR, që kanë të bëjnë me rolin e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale (DPO); certifikimin; kodet e sjelljes dhe



etikës; sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI), etj. Të pranishmit diskutuan edhe për raste nga praktika, si dhe për forcimin e përgjegjshmërisë në raport me të dhënat e qytetarëve, për të përmirësuar në vazhdimësi shërbimet që ky sektor ofron.

Në mjediset e Zyrës së Komisionerit, ambasadorja Huber u prit në një takim të veçantë nga z. Dervishi, në të cilin u diskutua rreth rrugëve për zgjerimin e bashkëpunimit për realizimin e projekteve të tjera të përbashkëta.

## Njohje, ndërgjegjësimit dhe edukim për mbrojtjen e të dhënave personale

Në kuadër të aktiviteteve për Javën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe në vigjilje të 28 Janarit, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Kolegjin Universitar të Biznesit zhvilluan një takim në formën e një leksioni të hapur. Të pranishëm ishin studentë dhe stafi akademik e administrativ nga ky institucion i arsimit të lartë (IAL) jo publik.



Në përshëndetjen e rastit, Komisioneri Dervishi, tha se aktivitete të tilla janë kthyer në traditë ndër vite me IAL publike e private. *“Për shkak të zhvillimit teknologjik dhe digjitalizimit të shumë veprimtarive, rreziku i keqpërdorimit të të dhënave personale është shtuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndaj, domosdoshmëria për mbrojtjen e tyre nis nga vetë ne si qytetarë, por duhet kërkuar edhe zbatimi i plotë i detyrimeve rregullore për parandalimin e dëmeve nga të gjithë kontrolluesit që mbledhin dhe përpunojnë të dhënat tona personale”* theksoi ai.

*“Për shkak të zhvillimit teknologjik dhe digjitalizimit të shumë veprimtarive, rreziku i keqpërdorimit të të dhënave personale është shtuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndaj, domosdoshmëria për mbrojtjen e tyre nis nga vetë ne si qytetarë, por duhet kërkuar edhe zbatimi i plotë i detyrimeve rregullore për parandalimin e dëmeve nga të gjithë kontrolluesit që mbledhin dhe përpunojnë të dhënat tona personale”* theksoi ai.

Prezantimin mbi legjislacionin në fuqi dhe për modernizimin e tij sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Bashkimin Evropian (GDPR), e mbajti znj. Pjerina Gaxha – Drejtor i Përgjithshëm i Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Nëpërmjet edhe shembujve nga praktika, të pranishmit u



njohën në tërësi me parimet dhe kriteret rregullore; të drejtat e qytetarëve; detyrimet e kontrolluesve/përpunuesve për marrjen e masave tekniko-organizative; sigurinë e të dhënave apo sfidat kryesore në këtë fushë. Në përgjigje të interesit të të pranishmëve, u ofruan këshilla praktike lidhur me sjelljen e individit në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale. Po ashtu, u theksua se përgjegjshmëria e kontrolluesve/përpunuesve, si në sferën publike ashtu edhe në atë private, rrit cilësinë e shërbimeve, sigurinë dhe transparencën e tyre për publikun.

## Partneritet për rritjen e transparencës në funksion të interesit publik

Zyra e Komisionerit vlerëson se bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile (OjF) dhe median është me rëndësi në funksion të ndërgjegjësimit për ushtrimin e të drejtave e lirive themelore të qytetarëve. Me këtë qëllim, u zhvillua takimi konsultativ me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga OjF dhe media për të diskutuar rreth ecurisë së zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, arritjet apo problematikat e hasura gjatë zbatimit të tij, si dhe fokusin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2023. Në takim u vlerësua kjo iniciativë e Zyrës së Komisionerit, e cila forcon partneritetin për objektivin e përbashkët, nxitjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së autoriteteve publike. Nëpërmjet ndërveprimit, sidomos duke marrë parasysh rolin dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile dhe medias për demokratizimin dhe zhvillimin e shoqërisë, pjesëmarrësit u angazhuan që kjo nismë të vijohet e të konsolidohet për shkëmbim idesh e qëndrimesh në funksion të interesit publik.



## Garantimi i të drejtave të qytetarëve, standarde bashkëkohore në zbatimin e kuadrit rregullator



Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Zyrës së Komisionerit dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës (AIP), u zhvillua takimi i dytë me pjesëmarrjen e stafeve përkatës, që kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit profesional, shkëmbimin/diskutimin e rasteve nga praktika administrative, si dhe planifikimin e nismave/projekteve për të ardhmen. Në këtë aktivitet, të dy Komisionerët, znj. Krenare Sogojeva-Dërmaku dhe z. Besnik Dervishi, theksuan rëndësinë e zhvillimit periodik të takimeve të kësaj natyre, duke vlerësuar se sfidat në të dy fushat e përgjegjësive institucionale janë shtuar dhe se kërkohet dinamikë tjetër për adresimin e tyre.



Aktiviteti u mbajt përgjatë dy ditëve, ku sipas agjendës u prezantua kuadri rregullator dhe veprimtaria e AIP, si dhe u trajtuan detyrat dhe përgjegjësitë e

strukturave përbërëse të autoritetit të Kosovës. Në këtë këndvështrim, Zyra e Komisionerit u angazhua në ofrimin e asistencës për zbatimin e kuadrit rregullator në fushën e të drejtës për informim, kryesisht, për hartimin/përditësimin e Programit të Transparencës, duke marrë në konsideratë përvojën pozitive të akumuluar në këtë drejtim në Shqipëri.



Nga ana tjetër, nga shqyrtimi i rasteve praktike për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, u ra dakord që të intensifikohet bashkëpunimi, edhe në kontekstin e zhvillimit të hetimeve të përbashkëta. Gjatë takimit u vlerësua kontributi i Zyrës së Komisionerit për anëtarësimin e AIP në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Njëkohësisht, u diskutua për harmonizimin e përpjekjeve për njohjen sa më të gjerë të autoritetit të Kosovës në kuadër të organizmave ndërkombëtare në të dy këto fusha.



## Udhëzuesi “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”

Zyra e Komisionerit e konsideron të rëndësishëm diskutimin për adresimin e sfidave elektorale në epokën digjitale, ushtrimin e të drejtës së votës nga qytetarët shqiptarë, në harmoni me garantimin e një tjetër të drejte, mbrojtjen e të dhënave personale.

Para nisjes së fushatës për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, Zyra e Komisionerit hartoi Udhëzuesin “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”, i cili u prezantua në një aktivitet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të pavarura, organizatave të shoqërisë civile dhe medias. Ky dokument ka për qëllim të orientojë subjektet zgjedhore mbi mënyrën se si të garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale të votuesve gjatë periudhës së fushatave zgjedhore. Realizimi i një procesi transparent nënkupton zbatimin rigoroz jo vetëm të legjislacionit specifik, por edhe të atij të fushës së përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit.

Në fjalën e tij, Komisioneri Dervishi, theksoi se zbatimi i parimeve dhe kriterëve të mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve ndihmon në forcimin e integritetit të zgjedhjeve dhe ruajtjes së besimit të proceset demokratike në epokën digjitale. *“Përpunimi i paligjshëm i tyre, mund të pengojë dialogun politik dhe ndikon negativisht tek e drejta e shprehjes së lirë politike. Subjektet zgjedhore, në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, konsiderohen kontrollues, duke mbledhur e përpunuar informacion personal të zgjedhësve. Këta aktorë zgjedhor, vetë apo nëpërmjet palëve të treta, bëjnë fushatë/propagandë duke përdorur mënyra e mjete të ndryshme komunikimi. Kjo veprimtari rregullohet nga Kodi Zgjedhor, por trajtimi i të dhënave personale, duhet, domosdoshmërisht, të jetë në përputhje me parimet dhe kriteret e legjislacionit në fuqi të kësaj fushe. Duke qenë se fushatat zgjedhore kanë evoluar dhe tashmë vihen në përdorim edhe mjete automatike/teknologji digjitale, subjektet zgjedhore kanë mundësi të “shënjestrojnë” (targetojnë) kategori të caktuara votuesish, masivisht dhe gjithnjë e në mënyrë më të sofistikuar. Asnjë ndikim apo presion i padrejtë nuk duhet ushtruar nga subjektet zgjedhore mbi zgjedhësit që të japin të dhënat personale ose të deklarojnë preferencat e tyre politike ose për kandidatë të caktuar.”*



Në fjalën e tij, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, z. Ilirjan Celibashi, vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin mes dy institucioneve për garantimin e të drejtave të qytetarëve, si dhe dokumentin e Udhëzuesit që u prezantua në këtë tryezë. *“Shpresoj se partitë politike dhe subjektet zgjedhore në fushatë do t’i respektojnë termat e këtij Udhëzuesi, pasi askush nuk i zotëron të dhënat personale të zgjedhësve, pasi këto të dhëna i takojnë vetëm shtetasve dhe asnjë partie politike në veçanti.”*

Udhëzuesi mbështetet në legjislacionin e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, praktikën ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar të kësaj fushe. Respektimi i rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale është thelbësor për të ruajtur besimin e qytetarëve, duke u garantuar kontrollin mbi të dhënat e tyre personale gjatë përpunimit për qëllime zgjedhore dhe duke siguruar mbarëvajtjen e procesit në të gjitha fazat e tij. Duke marrë në konsideratë rreziqet e mundshme që mund të sjellë përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale, Zyra e Komisionerit inkurajon të gjithë subjektet zgjedhore të zbatojnë dispozitat e legjislacionit në fuqi të kësaj fushe në çdo fushatë zgjedhore.

## Konsultimi publik i ndryshimeve në ligjin “Për të drejtën e informimit”



Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Komisionerit organizuan takimin konsultativ për diskutimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin ishin të pranishëm përfaqësues të autoriteteve publike, të organizatave të shoqërisë civile dhe medias. Këto përmirësime synojnë të forcojnë rregullat dhe procedurat e legjislacionit aktual në këtë fushë, duke ofruar zgjidhje optimale në njohjen me informacionin publik, si dhe për të konsoliduar kulturën e përgjegjshmërisë të administratës publike.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Ministri, z. Ulsi Manja, tha: “ky takim vjen në vijim të një procesi shumë intensiv konsultimi publik të këtij projektakti. Përgjatë tij janë shqyrtuar dhe marrë në konsideratë një sërë propozimesh konkrete nga aktorë të shoqërisë civile, të cilat janë reflektuar tashmë në këtë variant. Në rolin e dyfishtë të Ministrit të Drejtësisë dhe Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, monitorojmë me shumë vigjilencë të gjithë masat për forcimin e transparencës në Strategjinë Ndërsektorale kundër Korrupsionit. Gjetjet nga raportet e monitorimit përbëjnë një arsye më shumë për të nxitur çdo iniciativë që synon rritjen e llogaridhënies publike, përmes transparencës. Para së gjithash, projektligji synon të realizojë dy objektiva themelore: të shtojë detyrimet ligjore që mbartin autoritetet publike, si dhe të forcojë mekanizmat që garantojnë zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky ligj.”



Nga ana e tij, Komisioneri Dervishi, theksoi se pavarësisht se situata vijon të paraqesë problematika nga pikëpamja e transparencës së autoriteteve publike, kjo e fundit, ka ardhur në përmirësim, nga viti në vit. “Gjej rastin të vlerësoj bashkëpunimin dhe ndërveprimin me Ministrinë e Drejtësisë, për të harmonizuar në një produkt përfundimtar propozimet e Zyrës së Komisionerit, atyre të autoriteteve publike, por edhe të qytetarëve apo grupeve të interesit. Ndryshimet e ligjit synojnë të përmirësojnë mekanizmat e dhënies së informacionit e dokumentacionit kërkuar, të forcojnë kompetencat e autoritetit mbikëqyrës, të rrisin efektivitetin e autoriteteve publike në këtë fushë, si dhe të konsolidojnë rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit. Përbushja e detyrimeve si për transparencën proaktive – nëpërmjet publikimit/përditësimit të Programit të Transparencës; ashtu edhe në rastin e dërgimit të kërkesës për informacion, ka për qëllim përfundimtar kontrollin efektiv të veprimtarisë së institucioneve/strukturave shtetërore nga qytetarët. Ushtrimi i të drejtës për informim është, gjithashtu, edhe pjesëmarrje e tyre në mirëqeverisje, në funksion të interesit publik.”



Konstatimi i problematikave, të cilat janë bërë prezent në vijimësi në Raportet Vjetore të Zyrës së Komisionerit, kanë sjellë domosdoshmërinë për të përmirësuar këtë ligj dhe kjo iniciativë vjen e kombinuar edhe me procesin e modernizimit të kuadrit rregullator të mbrojtjes së të dhënave personale, transpozimin e GDPR të Bashkimit Evropian në legjislacionin shiptar. Qasja konstante e institucionit ka qënë dhe mbetet edukimi dhe kultivimi i kulturës së transparencës për autoritetet publike. Ndër


ndryshimet kryesore në këtë projektligj është përfshirja dhe zgjerimi i kompetencave të Komisionerit në fushën e të drejtës për informim, të cilat janë të listuara në ligjin aktual për mbrojtjen e të dhënave personale.





Roli i Zyrës së Komisionerit konsolidohet akoma edhe më shumë, çka mundëson forcimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të institucionit në kuadër të garantimit të ushtrimit në praktikë të të drejtës për informim nga qytetarët. Një risi tjetër, është detyrimi i autoritetit publik për zbatimin e vendimmarrjes së Komisionerit, mospërbushja e së cilës pasohet me sanksion administrativ për titullarin e autoritetit publik.

Një nga çështjet më të rëndësishme që është adresuar në këtë dokument, është përcaktimi i saktë dhe konkret i përgjegjësisë për mospërbushjen e dispozitave të legjislacionit për të drejtën e informimit. Zyra e Komisionerit, nga ushtrimi i hetimeve administrative në autoritetet publike, ka konstatuar në shumë raste se përgjegjësia për mosdhënien e informacionit nuk ka qenë e drejtpërdrejtë e koordinatorit. Por ligji aktual njeh si përgjegjës në procesin e trajtimit të kërkesës për informim vetëm këtë të fundit, i cili pavarësisht se i ka përbushur kompetencat, ngarkohet me përgjegjësi administrative për mosdhënien e informacionit. Adresimi i kësaj problematike ka për qëllim të qartësojë e të forcojë rolin e koordinatorit brenda strukturës së autoritetit publik. Ky përmirësim, kombinuar edhe me përfitim të një shtese në pagë për natyrën e veçantë të punës së koordinatorit, do të ndikojë në rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësit përballë qytetarëve. Një tjetër ndërhyrje përmirësuese është edhe rishikimi me ulje i kufijve të poshtëm të sanksioneve për dënimin e shkeljeve për mospërbushje të detyrimeve ligjore. Këto ndryshime synojnë të vendosin një raport më të drejtë dhe proporcional me të ardhurat në administratën publike. Projektakti është një kontribut për ta bërë legjislacionin e të drejtës për informim akoma edhe më të mirë, si dhe shprehje e vokacionit për një qeverisje me pjesëmarrjen e publikut. Këto ndryshime përmirësuese kanë patur në qendër të vëmendjes shqetësimet e qytetarëve apo grupeve të interesit. Ato synojnë të ofrojnë zgjidhjet më të përshtatshme në këtë drejtim, si dhe të ndikojnë në reduktimin e hapësirave për korrupsion, duke rritur besimin e publikut te administrata.



## Komisioneri, z. Besnik Dervishi, i ftuar në intervistë në Zërin e Amerikës

Komisioneri Dervishi ishte i ftuar në një intervistë për seksionin në gjuhën shqipe të Zërit të Amerikës (VoA), ku i pyetur për situatën e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, ndër të tjera tha: *“nga njëra anë mund ta shikojmë si problematike panoramën, por nga ana tjetër mund ta konsiderojmë edhe si ndërgjegjësime, si diçka pozitive, si ndërgjegjësime të lartë të qytetarëve, të medias, kryesisht asaj investigative dhe veçanërisht, të shoqërisë civile. Në rast se autoritetet publike do të funksiononin shumë mirë do ta jepnin informacionin dhe nuk do të kishte ankesa pranë Zyrës së Komisionerit, dhe nga ana tjetër, janë konstatuar mangësi, pamundësi apo shkaqeve të tjera, që ne nga viti në vit i përpunojmë dhe i bëjmë prezente në raportin që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë.”*



Intervista e plotë në

<https://www.zeriamerikes.com/a/7034507.html>

*Në lidhje me garantimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të kësaj fushe, Komisioneri theksoi: “ne si institucion përgjegjës jemi shumë të shqetësuar, por edhe të gjithë qytetarët duhet të jenë të shqetësuar. Në rradhë të parë, për ndërgjegjësimin e gjithsecilit prej nesh, sepse ne nuk e kemi kulturën e mbrojtjes së të dhënave personale, të mbrojtjes së identitetit tonë. Ana tjetër, që është po aq e rëndësishme, mbase edhe më e rëndësishme, është pjesa e kontrolluesve, publik (institucionet) apo privat, ku çdo i tillë ka detyrimin kushtetues që t’i përpunojë të dhënat personale në mënyrë të ligjshme, në zbatim të parimeve dhe kriterëve të përcaktuara ligjore. Kontrollues janë edhe partitë politike, të cilat, gjithashtu, duhet që përpunimin e të dhënave personale ta kryejnë në përputhje me kuadrin rregullator. Komisioneri ka nxjerrë një seri aktesh në lidhje me rastet e fundit të rrjedhjes dhe cenimit të të dhënave personale të qytetarëve, të cilat janë publike. Kjo është ajo që bën institucioni: monitoron, konstaton shkeljet dhe kur ka vend, vendos sanksione dhe si masë të fundit, urdhëron bllokimin e përpunimit të të dhënave personale kur kemi të bëjmë me shkelje të rënda.”*

## 15 vjet Zyra e Komisionerit, Konferenca V Kombëtare “E Drejta për Informim – Hapje, Transparencë, Digjitalizim”



Në këtë aktivitet të rëndësishëm, i organizuar falë bashkëpunimit të Zyrës së Komisionerit me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Zyrën e Këshillit të Evropës (KiE) në Shqipëri, morën pjesë mbi 150 përfaqësues të autoriteteve publike qendrore e të varësisë, të pavarura, të sistemit të drejtësisë apo të vetëqeverisjes vendore. Ky takim kishte në fokus vlerësimin e nivelit të zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Të ftuar nderi në këtë konferencë, ishin znj. Ermonela Felaj Valikaj, N/kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Milva Ekonomi, Ministër i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, z. Olsi Dekovi, Zv/kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës dhe z. Sam Goldbart, Sekretari Parë i Ambasadës Britanike.




Komisioneri Dervishi, theksoi në fjalën e tij se institucioni ka arritur të jetë funksional, i pavarur në vendimmarrje, laborator që performon dhe konkurren me kontributin e tij denjësisht në fushat e përgjegjësisë, e ndoshta dhe më gjerë. “Kjo veprimtari intensive përfshin edhe procesin e integritit evropian dhe atë në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, në dy prej të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të drejtën për informim dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, të hapur dhe komunikues me publikun dhe që meriton të vendoset në pozicionin e duhur

kushtetues dhe institucional. E drejta për informim, në të tre komponentet e saj, ku në qendër është qytetari së bashku me shoqërinë civile, median apo çdo aktor tjetër, me autoritetet publike si dhe Zyra e Komisionerit, duhet të funksionojnë bazuar në një marrëdhënie luajliliteti institucional, sepse kjo garanton zbatimin e kësaj të drejte për të parët, ashtu si dhe reflekton transparencën dhe mirëqeverisjen për institucionet publike. Duke besuar te ky luajlilitet, Zyra e Komisionerit e ka ndërtuar strategjinë e punës së saj te edukimi dhe ndërgjegjësimi. Ne besojmë fort se, rregulli është transparenca, kufizimi i informacionit është përjashtim nga ky rregull.”



Në fjalën e saj përshëndetëse, znj. Felaj, vlerësoi se “edhe pse institucion ende i ri, me një histori të shkurtër 15-vjeçare, Komisioneri ka krijuar tashmë një bilanc të pasur dhe po kontribuon për të kultivuar një kulturë të re për transparencën e autoriteteve publike. Me punë, kontribut, performancë profesionale e dinjitet, institucioni ka zënë vendin e tij të rëndësishëm në kontekstin e insitucioneve të pavarura, si gardianë të interesit publik dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.”



Video-prezantimi për aktivitetin 15-vjeçar  
<https://www.youtube.com/watch?v=ZxAPyyc8xHo>



Në fjalën e saj, znj. Ekonomi theksoi se “*insitucioni juaj ka krijuar tashmë traditën e mirë të raporteve vjetore që pasqyrojnë punën e administratës publike në përgjithësi, si dëshmi jo vetëm e arritjeve, por edhe të autokorrigjimit. Jeni një institucion me reputacion të mirënjohur, dëshmi e të cilës është edhe vendimi për mbajtjen e Konferencës së ICIC në vitin 2024 në Tiranë.*”



Për z.Dekovi “*Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në miratimin e standardeve të përparuara ligjore në fushën e të drejtës për informim. Ratifikimi i Konventës 205 është një hap thelbësor për të rritur legjitimitetin e autoriteteve publike, duke nxitur integritetin, efikasitetin, efektivitetin dhe llogaridhënien e tyre, duke promovuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimet që ndikojnë në të ardhmen tonë të përbashkët.*”

Zyra e Komisionerit prezantoi në këtë aktivitet, me znj. Elona Hoxhaj – Drejtor i Përgjithshëm i të Drejtës për Informim, një panoramë të përmbushjes së detyrimeve të legjislacionit, situatën e transparencës proaktive apo aksesin nga qytetarët dhe grupet e interesit në informacionin publik që prodhojnë/disponojnë institucionet. E drejta për informim, si një nga të drejtat themelore të njeriut, vepron si parakusht për një qeverisje të hapur, që garanton transparencë dhe llogaridhënie. Transparenca është element kyç në një shoqëri demokratike dhe shërben për t'i dhënë qytetarëve, shoqërisë civile dhe medias mjetet për të vlerësuar se si administrohet pushteti dhe burimet e shtetit.



Pikë e rëndësishme në agjendën e konferencës ishte prezantimi i portalit qeveritar për të dhënat e hapura [opendata.gov.al](http://opendata.gov.al), nga znj. Romina Kostani, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Kjo platformë përbën një nga detyrimet që burojnë nga zbatimi i ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Me shumë interes u ndoq fjala e ekspertit të KiE, z. Cesare Pitea, i cili diskutoi mbi risitë e Konventës “Për aksesin në dokumente zyrtare”, dokument që ka vendosur standarde bashkëkohore në këtë fushë jo vetëm për hapësirën evropiane. Ndërsa, znj. Vasilika Laçi foli për bashkëpunimin me Ambasadën Britanike në realizimin e projektit “Përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë së qeverive të Ballkanit Perëndimor përmes zhvillimit të komunikimeve efektive strategjike.”



## Samiti Vjetor i IAPP, takime të Komisionerit Dervishi me zyrtarë të lartë amerikanë



Komisioneri Dervishi, zhvilloi një vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadër të pjesëmarrjes në Samitin Global Vjetor 2023 të Shoqatës Ndërkombëtare të Profesionistëve të Privatësisë (International Association of Privacy Professionals – IAPP). Në kuadër të Ditës së Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave u zhvilluan disa aktivitete të ndryshme, ku u trajtuan sfida e problematika të natyrave të ndryshme, si dhe u ndanë eksperiencat më të mira e bashkëkohore ndërkombëtare në këtë fushë, që ndërlidhen me përparimin e teknologjisë dhe krijimin e një mjedisi sa më të sigurt digjital.



Në Departamentin e Drejtësisë u zhvillua një takim i rëndësishëm me zyrtarë të lartë amerikanë nga Shtëpia e Bardhë, Departamenti i Shtetit, ai i Drejtësisë, ai i Tregtisë, Zyra e Inteligjencës Kombëtare, etj dhe atyre evropianë - Komisionerë të Mbrojtjes së të Dhënave nga disa shtete të BE dhe jo vetëm. Temat e diskutimeve u përqendruan mbi kuadrin ligjor për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, forcimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit duke zbatuar praktikatat më të mira bashkëkohore, si dhe në respektimin e të drejtave të qytetarëve në harmoni me zhvillimin teknologjik dhe atë ekonomik.



Pjesë e aktiviteteve të Ditës së Autoriteteve ishte edhe pritja që organizoi Kryetarja e Komisionit Federal të Tregtisë, Lina Khan, ku të pranishëm ishin zyrtarë të lartë pjesëmarrës në Samitin Global Vjetor të IAPP. Intensifikimi i bashkëpunimit në këtë fushë ishte ndër pikat kryesore të diskutimeve, si dhe forcimi i rregullave për një mjedis të sigurt kibernetik/digjital për mbrojtje efektive të privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarë.

## Ambasadori i Prezencës së OSBE në Shqipëri viziton Zyrën e Komisionerit

Z. Besnik Dervishi, priti në një takim Ambasadorin z. Guido De Sanctis, Kryetar i Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Komisioneri shprehu falënderimin për kontributin dhe mbështetjen e dhënë ndër vite nga OSBE, si dhe për realizimin me sukses të disa projekteve të përbashkëta, të zhvilluara për të dy fushat e përgjegjësive së institucionit.



Gjatë takimit Ambasadori De Sanctis u njoh me rolin, funksionet dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, si edhe me procesin e harmonizimit të kuadrit rregullator kombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale me acquis të BE, apo dhe atë për përmirësimin e ligjit për të drejtën e informimit. Palët diskutuan dhe u dakordësuan për të vijuar këtë bashkëpunim në funksion të njohjes dhe ndërgjegjësimit për ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore nga qytetarët.

## Procesi i integritit evropian, përmirësimi i kapaciteteve profesionale

Në kuadër të procesit të integritit evropian të vendit, Zyra e Komisionerit ka një rol aktiv duke qënë pjesë aktive e tij, ndër të tjera, edhe për Reformën në Administratën Publike (PAR).

Për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative, Bashkimi Evropian do të mbështesë projektin “Qelizat e Reja” (Young Cells), i cili parashikon zhvillimin e trajnimeve dhe praktikave në institucione të vendeve anëtare të Unionit.

Zyra e Komisionerit është një prej autoriteteve të përfshira në këtë iniciativë dhe për këtë qëllim, u zhvillua takimi me ekspertet e projektit znj. Anne Azam-Pradeilles dhe znj. Maylis De Verneuil.

Zbatimi i tij bazohet në përzgjedhjen mbi bazë merite dhe përgatitjen e një numri nëpunësish të administratës publike shqiptare, duke patur në konsideratë edhe prioritetet në funksion të procesit të negociatave me BE.



## Roli global i të drejtës për informim për konsolidimin e demokracisë - Konferenca e 14-të e ICIC



“Ndërveprimi mes shteteve: Roli global i të drejtës për informim për konsolidimin e demokracisë, gjithëpërfshirjen dhe zhvillimin” ishte tematika e edicionit të 14-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Ky është aktiviteti kryesor vjetor botëror në këtë fushë, në fokus të të cilit është forcimi i transparencës dhe integritetit të autoriteteve publike. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të autoriteteve anëtare/vëzhguese të organizatës nga të gjitha kontinentet, por edhe nga

organizma partnere, bota akademike, shoqëria civile, media, etj.

Përgjatë 2 ditëve të punimeve të Sesionit të Hapur pjesëmarrësit diskutuan për çështje të rëndësishme, si: forcimin e veprimtarisë së institucioneve mbikëqyrëse të të drejtës për informim; aksesin në informacion si një përgjigje ndaj sfidave moderne të demokracisë, apo rolin e kësaj të drejte në nxitjen e zhvillimit ekonomik-shoqëror. Tema të tjera me interes për pjesëmarrësit ishin edhe ato që kanë të bëjnë me: prokurimet publike transparente që ndikojnë në efektivitetin e kostove për ekonominë; keqinformimi, rreziqet dhe përdorimi i inteligjencës artificiale; si dhe krahasimi i modeleve të ndryshme rregullatore dhe nevoja për përmirësimin/forcimin e standardeve ligjore. Gjithashtu, të pranishmit morën pjesë edhe në takime të rrjeteve e grupeve rajonale apo në seminare/workshope paralele, ku u diskutua mbi ndërveprimin e organizmave publike me sektorin privat në kuadër të transparencës; trajtimin e rasteve në optikën e të drejtës për informim që lidhen me problematikat me bazë gjinore apo për grupet e cënueshme.



Zyra e Komisionerit është përzgjedhur si organizatore e ardhshme e këtij forumi, në vitin 2024. Z. Dervishi, mbajti një fjalë përsëritëse, ku tha se zhvillimi i kësaj Konference për herë të parë në Tiranë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor është shumë i rëndësishëm. “*Ne udhëhiqemi nga vizioni i përbashkët për promovimin e ushtrimit të të drejtës për informim dhe transparencës në një mjedis gjithnjë e më shumë të ndërlidhur. Besojmë se këto vlera janë thelbësore për zhvillimin e shoqërive demokratike*” – theksoi ai. Me këtë rast, u paraqit edhe një video-prezantim për Konferencën e ardhshme.



Në punimet e Sesionit të Mbyllur të ICIC u raportua rreth veprimtarisë së 12 muajve të kaluara dhe u miratua Raporti Vjetor; ashtu si dhe u realizuan raportimet respektive të grupeve të punës apo rajonale mbi zhvillimet në këtë fushë. Zyra e Komisionerit është anëtare në dy nga

Grupet e Punës, atë për promovimin e transparencës proaktive dhe mbi trajnimet. Sipas agjendës, u miratuan ndryshimet e propozuara në Kartën e Johannesburgut, u mbajtën zgjedhjet për anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv për periudhën 2023-2026, si dhe u diskutua në lidhje me ecurinë e bashkëpunimit strategjik ICIC-UNESCO.

Gjithashtu, u zhvillua edhe një mbledhje e Komitetit Ekzekutiv ku u paraqitën vlerësimet dhe konkluzionet për ecurinë e edicionit të 14-të të ICIC. Në këtë takim, Komisioneri Dervishi theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit dhe ndërveprimit mes institucioneve mbikëqyrëse, në funksion të rritjes së transparencës së autoriteteve publike.





## Forum për rolin e Zyrës së Komisionerit në promovimin e të drejtës për informim

Me tematikën “E drejta e informimit në Shqipëri: vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, u zhvillua forumi për trajtimin e veprimtarisë institucionale nga këndvështrimi i studimeve akademike. Si nismë e mbështetur nga Zyra e Komisionerit, ky aktivitet u mbajt në kuadër të projektit të përbashkët të

Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), programit Ekspertiza Hulumtuese nga Diaspora Akademike (READ) dhe Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës. Në këtë forum ishin të pranishëm përfaqësues nga bota akademike, shoqëria civile, si dhe koordinatorë për të drejtën e informimit të institucioneve qendrore e të pavarura.

Në fjalën e tij, Komisioneri Dervishi, vlerësoi nismën, duke theksuar domosdoshmërinë e nxitjes së projekteve të kësaj natyre në funksion të hapjes së autoriteteve publike. *“Veprimtaria e Zyrës është udhëhequr nga promovimi i kulturës për respektimin e të drejtave të qytetarëve, si themel për një shoqëri demokratike, të zhvilluar, për institucione të përgjegjshme dhe transparente. Çdo kontribut që mbështet këtë frymë është i mirëpritur, nga bota akademike, organizata të shoqërisë civile apo grupet e interesit.”*



Studuesit ndanë me të pranishmit gjetje të projektit, që ka trajtuar veprimtarinë e institucionit për shqyrtimin e ankesave gjatë periudhës 2020-2022 dhe sidomos, vendimmarrjen e Komisionerit, në funksion të krijimit të praktikës dhe standardeve rregullatore në këtë fushë. Në këtë këndvështrim, u sollën për të pranishmit, edhe raste krahasimore nga përvoja në vende të Bashkimit Evropian. I organizuar në formën e një tryeze të rrumbullakët, në këtë forum u diskutua mbi forcimin e pavarësisë institucionale të Zyrës së Komisionerit, nxitjen e

transparencës proaktive të autoriteteve publike apo fuqizimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit.

## Kuvendi miraton Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2022

Komisioneri, z. Besnik Dervishi, në punimet e seancës plenare të datës 08.06.2023 të Kuvendit të Shqipërisë, prezantoi Raportin për veprimtarinë e institucionit për vitin 2022. Sipas procedurës, Kuvendi miratoi dhe Rezolutën *“Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2022.”*



## Zbatimi i legjislacionit për fushat e përgjegjesisë, takime në Gjirokastrë

Zyra e Komisionerit zhvilloi në qytetin e Gjirokastrës një aktivitet me 3 komponentë: për ndërgjegjësimin e qytetarëve, takim me përfaqësues të institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë qark, si dhe shkëmbimin e praktikës së mirë në kuadër të transparencës me publikun.



Me fokus ndërgjegjësimin e qytetarëve, stafi i Zyrës së Komisionerit bashkëbisedoi me ta për t'iu shpjeguar ushtrimin e të drejtave të tyre në fushën e aksesit në informacionin/dokumentacionin publik, në atë të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe shpërndau botime të ndryshme. Gjatë ditës së dytë,



në bashkëpunim me Prezencën në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), u zhvillua takimi njohës e ndërgjegjësuës për zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe atij për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë aktivitet morën pjesë, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, zyrtari i lartë ligjor i OSBE, z. Mauro Puzzo, Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, z. Flamur Golemi dhe përfaqësues të autoriteteve të ndryshme publike të këtij qarku. Ky takim kishte si qëllim prezantimin e kuadrit rregullator për të dy fushat e përgjegjesisë të institucionit, ashtu si dhe veprimtarinë monitoruese e mbikëqyrëse për zbatimin e tyre. Gjithashtu, vëmendje i kushtua risive që do të sjellë legjislacioni i ardhshëm kombëtar për mbrojtjen



e të dhënave personale, që transponon tërësisht Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR), si dhe ndryshimeve e përmirësimeve të ligjit "Për të drejtën e informimit". Në përfundim të aktivitetëve në këtë qytet, Komisioneri Dervishi iu bashkua stafit të Bashkisë Gjirokastrë në takime me qytetarë, për të ndarë eksperiencën më të mirë në transparencën proaktive dhe trajtimin e kërkesave për informacion sipas standardeve ligjore.



## Procesi i integritit evropian, kontributi i Zyrës së Komisionerit

Zyra e Komisionerit mori pjesë në mbledhjen e 14-të të Nënkomitetit "Drejtësia, Liria dhe Siguria", ku raportoi mbi çështjet që kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave me acquis të BE, efikasitetin dhe pavarësinë e institucionit, si dhe aksesin dhe sigurinë e të dhënave të ruajtura në databazat shtetërore. Në takim,

ekspertët e BE vlerësuan pozitivisht veprimtarinë e institucionit në ushtrimin dhe përmbushjen e kompetencave ligjore për rastet e cenimit të të dhënave personale të qytetarëve të ndodhura vitet e fundit. Gjithashtu, u theksua kontributi dhe angazhimi serioz i Zyrës dhënë në procesin e përafrimit të kuadrit rregullator shqiptar të mbrojtjes së të dhënave personale me acquis të BE, si dhe u shpreh mbështetja maksimale për finalizimin e tij.

Po ashtu, institucioni mori pjesë në takimin e 11-të për Reformën në Administratën Publike (PAR), ku u raportua për ecurinë e zbatimit të detyrimeve në përditësimin e Programit të Transparencës dhe për hartimin e dokumentit të Planit të Integritetit nga autoritetet publike si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor.





## Legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale, forumi i biznesit nga Dhoma Amerikane e Tregtisë

Me tematikë “Siguria kibernetike, agjenda digjitale dhe mbrojtja e të dhënave personale” u organizua nga Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham) një forum biznesi, ku e ftuar ishte dhe Zyra e Komisionerit. Në fokus të diskutimeve ishin risitë e zbatuara në këtë fushë, legjislacioni i ardhshëm kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, ndikimi i kuadrit rregullator evropian apo edhe më gjerë në komunitetin e biznesit, si dhe sfidat në lidhje me sigurinë kibernetike në epokën digjitale.



Zyra e Komisionerit u përfaqësua në këtë takim me znj. Besa Velaj, Drejtor i Kabinetit. Ajo prezantoi procesin e hartimit të legjislacionit të ri në këtë fushë, i cili transpozon tërësisht Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR). Kuadri i ardhshëm rregullator rrit kontrollin e qytetarëve mbi përpunimin e të dhënave të tyre personale, duke iu përgjigjur zhvillimeve të teknologjisë në epokën digjitale. Nga



ana tjetër, legjislacioni i ri do të rrisë detyrimet për kontrolluesit/përpunuesit përsa i përket elementëve të tillë, si: informimi dhe marrja e pëlqimit nga individët; etika, integriteti dhe përgjegjshmëria në proceset përpunuese; për masat e sigurisë; futjen e koncepteve inovative: e drejta për t'u harruar, transferueshmëria e të dhënave, privatësia në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar (privacy by default and by design); etj. Një aspekt tjetër i tij është edhe forcimi i rolit dhe funksioneve të Zyrës së Komisionerit, në garantimin e ushtrimit praktik të kësaj të drejte dhe lirie themelore të individit. Miratimi nga Kuvendi i kuadrit të ardhshëm rregullator vendos standarde bashkëkohore, për një zhvillim të qendrueshëm ekonomik-shoqëror, si dhe do të rrisë besimin e qytetarëve ndaj kontrolluesve publik/privat në raport me shërbimet që ata ofrojnë.

## Shkëmbimi i praktikave të mira në funksion të transparencës së Autoriteteve Publike

Zyra e Komisionerit mori pjesë në Takimin e 2-të të Punës të Rasteve të Veçanta (Case Handling Workshop-CHW). Ky takim u organizua nga Autoriteti Federal për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Gjermanisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga mbi 20 institucione homologe evropiane. Në fokus të diskutimeve e shkëmbimit të eksperiencave në këtë takim ishin ngjashmëritë ligjore dhe mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit rregullator, ashtu si edhe raste praktike.

Përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit prezantuan 2 çështje me ndjeshmëri të lartë në Shqipëri si “Transparenca proaktive efektive e Autoriteteve Publike” dhe “Informacioni publik në çështjet gjyqësore”. Pjesëmarrësit në takim patën pyetje të shumta rreth këtyre temave. I ftuar i nderit në aktivitet ishte dhe një përfaqësuesi i organizatës jo fitimprurëse në Gjermani



“Open Knowledge Foundation”, i cili ndau me të pranishmit eksperiencën e platformave elektronike dhe fushatave të shoqërisë civile për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve ndaj të drejtës për informim publik. Ushtrimi i të drejtës për informim nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile apo dhe medias ka ndikuar në rritjen dhe përmirësimin e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike ndër vite. Nga ana tjetër, shkëmbimi i përvojave në takime të kësaj natyre nxit zgjerimin e njohurive dhe praktikave, në funksion të forcimit të kulturës së transparencës.

## Projekti “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave”

Në epokën digjitale, përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale është i ndërlidhur me marrjen e masave të duhura për siguri të pajisjeve dhe sistemeve. Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Zhvillim të Qendrueshëm (ASDO), me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Tiranë, kanë zhvilluar disa aktivitete njohëse dhe ndërgjegjësuese në kuadër të projektit “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave.”

Këto takime u zhvilluan me studentë e pedagogë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës, me nxënës e mësues të shkollave 9-vjeçare “1 Maji”, “Ali Demi” dhe “Elina”, me përfaqësues të strukturave publike e private shëndetësore, atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e pasurive të paluajtshme, organizatave të shoqërisë civile apo medias. Këto aktivitete kishin në fokus domosdoshmërinë për njohjen me kuadrin ligjor të fushës në një mjedis gjithnjë e më shumë të përparuar teknologjik/digjital, për në ofrimin



e shërbimeve me cilësi e të sigurta dhe për garantimin e plotë të të drejtave të qytetarëve.

Stafi i Zyrës së Komisionerit dhe eksperti i projektit, z. Emirjon Marku, shpjeguan për pjesëmarrësit në takime parimet dhe kriteret që përcaktojnë legjislacionin për një proces të rregullt të përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve, duke i ilustruar edhe me shembuj konkretë nga praktika. Sektorët e sipërpërmendur konsiderohen ndër kontrolluesit e mëdhenj për shkak të llojit dhe sasisë së të dhënave personale

që përpunojnë, duke patur parasysh, edhe numrin e lartë të individëve të përfshirë në këtë proces. Në vlerësim të kësaj pozite, është e rëndësishme që të kuptohet se marrja e masave të duhura tekniko-organizative, përfshi edhe një mjedis digjital/kibernetik të sigurt, ndikon në parandalimin dhe minimizimin e rasteve të cenimit të të dhënave personale. Një çështje me rëndësi që u trajtua gjatë takimeve të këtij projekti ishte ajo e iniciimit të programeve apo trajnimeve specifike, me përmbajtje ndërdisiplinore dhe metodologji të reja në kurrikulat e tyre, si brenda strukturave arsimore ashtu



edhe në bashkëpunim me palë/aktorë të tjerë të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale.

Në mënyrë të veçantë, në aktivitetet e zhvilluara në shkollat 9-vjeçare, u prezantua loja “Happy onlife”. Për nxënësit e mësuesit pjesëmarrës, kjo nismë nxit të menduarin kritik të të rinjve, sidomos, për sjelljet që ata duhet të përshtasin gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Të pranishmit u njohën, gjithashtu edhe me ushtrimin e të drejtave të tyre, apo me këshilla praktike për përdorimin e sigurt të mjedisit digjital/kibernetik.





## Konsultimi i “Udhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) me mbështetjen e Qendrës për Çështjet e Informimit Publik (INFOÇIP) zhvilluan një tryezë në kuadër të diskutimeve për hartimin e “Udhëzuesit standard

të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”. Në takim ishte i ftuar Komisioneri, z. Besnik Dervishi, anëtarja e KLGJ e caktuar për marrëdhëniet me median dhe publikun, znj. Marçela Shehu, gjyqtarë, ekspertë dhe përfaqësues të mediave.

Komisioneri i njohu të pranishmit me veprimtarinë institucionale në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi në të dy fushat e përgjegjësisë për garantimin e të drejtave themelore të qytetarëve. Gjatë kësaj tryeze konsultimi publik diskutimet u përqendruan te rekomandimet e përfaqësuesve të mediave në përmirësimin e këtij Udhëzuesi. Qëllimi është vendosja në balancë e misionit të saj për informimin me integritet e profesionalizëm të publikut dhe detyrimin e gjykatave për të ofruar transparencë dhe standarde ligjore që garantojnë të drejtat e njeriut dhe nuk censurojnë punën e medias.



## KOMISIONERI NË MEDIA



A2 CNN

**Revista “Informim Dhe Privatësi”**

**Përgatitet dhe botohet nga  
Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit  
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Qershor 2023**

**Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5**

**Kodi postar 1001**

**Tiranë**

**Tel: +355 42237200**

**Nr. i gjelbër: 08002050**

**[www.idp.al](http://www.idp.al)**

**[info@idp.al](mailto:info@idp.al)**